



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Më/Dana 21-05-2013			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/430			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të dispozitave nenit 12.2 shkronja c) lidhur me nenin 40.2 shkronja a) të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 (G.Z e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36.2, shkronja c) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, të dispozitave të Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit, Ligjit të Shërbimit Civil, Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, si dhe dispozitave të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14.05.2013 aprovon këtë:

RR E G U L L O R E PËR BARAZI GJINORE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizimet

Neni 1

1.1 Barazi gjinore - do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.

1.2 Trajtim i barabartë gjinor - do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.

1.3 Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor - do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

1.4 Diskriminim i tërthortë gjinor - do të thotë vënia e individit të njëjës gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjane, standartet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarte apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjë gjini.

1.5 Parimin e trajtimit të barabartë - që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

1.6 Masat ligjore - janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

1.7 Masat e përgjithshme - janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

1.8 Masat e veçanta - janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njërës gjini.

1.9 Përfaqësimi i pabarabartë - është atëherë kur përfaqësimi i njërës gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE

Neni 2

2.1. Me zbatimin e masave afirmative të vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve si në organet e Administratës Komunale, dhe në institucione tjera, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e përfaqësimit të përcaktuar në Ligjin për Barazi Gjinore.

2.2. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

2.3. Gjatë emërimit në pozita të larta të institucioneve komunale, si dhe rekrutimit të stafit nëpër të gjithë sektorët, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 2.2.

2.4. Organet komunale gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda institucioneve komunale obligohen të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve.

2.5. Institucionet komunale, në pajtim me kompetencat e tyre, oblogohen të promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

2.6. Vendimet që marrin organet e qeverisjes si, Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore nga Zyrtarja për Barazi Gjinore

2.7. Shërbimi civil në saje të paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë duhet të reflekton barazinë gjinore.

2.8. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht

nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike.

MBLEDHJA E INFORMATAVE DHE STATISTIKAT GJINORE

Neni 3

3.1. Të dhënat dhe informatat statistikore të cilat i mbledhin, i evidentojnë dhe i përpunojnë organet komunale në të gjithë sektorët, të paraqiten sipas struktures gjinore.

3.2. Programet, raportet, analizat dhe projektet të cilat i përgatisin organet komunale, duhet të përfshijnë aspektin gjinor.

SHOQËRIA CIVILE

Neni 4

4.1. Organizatat jo-qeveritare bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre në fushën e barazisë gjinore me institucionet komunale

4.2. Subjektet e shoqërisë civile kontribojnë në zbatimin e Rregulloreve dhe akteve tjera administrative, duke bashkëpunuar me institucionet komunale në përgjithësi

EKONOMIA

Neni 5

5.1 Organet përgjegjëse komunale në përgjithësi si dhe institucionet financiare në veçanti, obligohen t'u sigurojnë femrave qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit (masë afirmative)

PUNA

Neni 6

6.1. Sektori publik, privat si dhe organet vendimmarrëse dhe ekzekutive, obligohen të sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.

6.2. Gjatë shpalljes së vendit të lirë të punës ndalohet përmbajtja e fjalëve apo shprehjeve që diskriminojnë në baza gjinore.

6.3. Në rast se në ndonjë institucion, përfaqësimi gjinor nuk e ka arritur kuotën 40%, vendi i lirë i punës, në kushte të barabarta të përfshijë kriterin e përparësisë së rekrutimit të femrave(masë afirmative).

6.4. Punëdhënësi/Punëdhënësjja, është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës.

6.5 Ndalohet cdo lloj fyerje që cenon dinjitetin njerztor të punëtorëve në vendin e punës në baza gjinore

6.6. Punëdhënësi/Punëdhënësjja të sigurojë që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera.

ARSIMI DHE EDUKIMI

Neni 7

7.1 Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit të mundësohet arsimimi dhe edukimi barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrje e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dh në tregun e punës.

7.2. Drejtoria për arsim dhe drejtoritë shkollore, obligohen të zbatojnë dhe mbikqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht përsa i përket: qasjes në arsim dhe edukim, përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra;.

7.3. Në shkolla ndalohet çdo lloj diskriminimi gjinor ndaj stafit të mësimdhënies, nxënësve si dhe personelit teknik

MEDIAT

Neni 8

8.1 Të gjitha mediat lokale (media të shtypura, media audiovizuale, media elektronike) duhet të ndikojnë në kultivimin e vetëdijes së përgjithëshme për barazinë e femrave dhe meshkujve, duke promovuar rolin e barabartë të femrave dhe meshkujve në shoqëri

8.2. Ndalohet emetimi i programeve, botimi dhe publikimi i materialeve dhe informatave si dhe shpërndarja e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor.

8.3. Ndalohet shfaqja publike dhe paraqitja e çdo individi në mënyrë ofenduese, nënçmuese apo poshtëruese përsa i përket gjinisë

BARAZIA GJINORE DHE TË DREJTAT CIVILE

Neni 9

9.1. Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit dhe sjell të drejta dhe detyrime për të kurorëzuarit

9.2. Kurorëzimi lejohet me arritjen e moshës madhore, nga mosha 18 vjecare dhe në raste të veçanta ashtu siç është përcaktuar me ligj

9.3. Ndalohen martesat e kushtëzuara, të dhunshme dhe në kundërshtim me vullnetin e personave që do të lidhin martesë

9.4. Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.

9.5. Puna e përbashkët e bashkëshortëve me të cilën fitohet pasuria e përbashkët, konsiderohet kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët..

9.6. Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta përkatësisht ashtu si është e rregulluar me ligj.

9.7. Në rast vdekje të njërit prej bashkëshortëve, pasuria trashëgimore ndahet ndërmjet bashkëshortit/bashkëshortes dhe trashëgimtarëve të tjerë në pajtim me ligjin e trashëgimise.

9.8. Fëmijët, femra dhe meshkuj trashëgojnë pasurinë në mënyrë të barabartë në pajtim me ligjin.

9.9. Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj, mund të disponojnë me pjesën e tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë, pas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.

BUXHETIMI GJINOR

Neni 10

10.1. Institucionet komunale, në të gjithë sektorët obligohen të sigurojnë ndarjen dhe menaxhimin e financave publike përmes aplikimit të buxhetimit gjinor, ndarjes së drejtë të buxhetit në baza gjinore

10.2. Institucionet komunale, gjatë hartimit të politikave komunale, procesit të planifikimit të buxhetit, të planifikojnë buxhet për të dy gjinitë, duke marrë për bazë prioritetet e femrave dhe meshkujve.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 11

11.1. Në afat prej 1 muaj prej hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, Zyrtarja për Barazi Gjinore i paraqet Kryetarit të Komunës dhe sektorëve tjerë, Planin e Veprimit për zbatimin e Rregullores.

11.2. Për zbatimin e kësaj Rregullore, përgjegjës janë Zyra e Kryetarit dhe organet tjera komunale.

11.3. Për monitorimin e zbatimit të Rregullores, përgjegjës është Komiteti për Barazi Gjinore i Kuvendit të Komunës

Neni 12

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

12.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi, ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.



KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi